



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 5014 Prot.
9

Patos më 07.03.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 29.02.2024

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë :

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Albiona Lamaj
2. Armand Ahmetaj
3. Klaudio Alisininaj
4. Erald Çepele
5. Ertilla Myrtaj
6. Renaldo Shpata
7. Vjollca Kasaj
8. Novrus Toska
9. Smerald Hazizaj
10. Liljana Mesutaj
11. Eduart Faslliaj
12. Elmira Rama
13. Enkelejda Ajazi
14. Elton Seraj
15. Lori Musaj
16. Suela Hoxhaj

Takimi hapet nga Kryetari i Këshillit Z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Zhvillojmë sot këtë mbledhje në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar përkatësisht neni 53 , dhe 53, 58 të “Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin të Këshillit Bashkiak”.

Mbledhjen e deklaroj të hapur, filloj me leximin e rendit të ditës.

Bashkiak Patos, me këtë rend dite:

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 12.02.2024.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 12.02.2024.
- 4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Janar 2024”.
- 5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Janar 2024”.
- 6- Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis 2024-2029”.
- 7- Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë” 2024-2026 në Bashkinë Patos .
- 8- Projekt-vendim “Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave të veta (Bashkia Patos 2025-2027)”.
- 9- Projekt-vendim “Për miratimin e bonusit të qirasë së qytetarit z. Qerem Zyberi”.
- 10- Projekt-vendim “Për miratimin e bonusit të qirasë së qytetarit z. Bardhul Aliaj”.
- 11- Projekt-vendim “Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për rikonstruksion banesash”.
- 12- Projekt-vendim “Për miratimin e dhënies në përdorim të apartamentit nr. 1 të ish kopshtit me kontratë huapërdorje për qytetarin z. Viktor Abazaj.

Shkëlqim Beqiraj- Kryetar ekzekutivi kërkon të fusi në rendin e ditës dhe dy pika .

1. Projektvendim për ndryshim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023 “ Mbi miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, Njësive Administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024”.
2. Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4- mujorin e tretë dhe prej fillimit të vitit 2023.

Armand Ahmetaj – Kemi një kërkesë nga ekzekutivi, si rregull shqyrtohen në fund të rendit të ditës. Projekt-vendim për ndryshim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023 “ Mbi miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, Njësive Administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024”. Si pikë renditet në pikën e 13 dhe Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4- mujorin e tretë dhe prej fillimit të vitit 2023 renditet në pikën e 14.

Eduart Faslliaj- Në gjykimin tim projekt-vendimi për pagat është një pikë që duhet të kaloj në komisionin e ekonomisë ndërsa për pikën tjetër nuk kisha ndonjë vrejte, le të kaloj në rendin e ditës por kjo pikë duhet të kaloj nga komisioni i ekonomisë dhe duhet parë me detaje dhe nuk mendoj se koha është e mjaftueshme për ta parë.

Armand Ahmetaj – Unë mendoj ta degjojme ekzekutivin dhe e kemi gjithë kohën e nevojshme për ta shqyrtuar në fund.

Eduart Faslliaj- Ju mund ta vendosni kryetar sepse edhe kartonat nuk ju mungojnë por unë mendoj se është në shkelje të rregullores.

Armand Ahmetaj- Nuk ka asgjë në shkelje të rregullores. Gjatë një mbledhje të këshillit Bashkiak mund të bëhen propozime jo vetëm nga ekzekutivi për të shtuar pika në rendin e ditës por edhe nga qytetarët në zbatim të ligjit.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord me rendin e ditës?

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 12.02.2024.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 12.02.2024.
- 4- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Janar 2024".
- 5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Janar 2024".
- 6- Projekt-vendim "Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis 2024-2029".
- 7- Projekt-vendim "Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë" 2024-2026 në Bashkinë Patos .
- 8- Projekt-vendim "Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave të veta (Bashkia Patos 2025-2027)".
- 9- Projekt-vendim "Për miratimin e bonusit të qirasë së qytetarit z. Qerem Zyberi".
- 10- Projekt-vendim "Për miratimin e bonusit të qirasë së qytetarit z. Bardhul Aliaj".
- 11- Projekt-vendim "Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për rikonstruksion banesash".
- 12- Projekt-vendim "Për miratimin e dhënies në përdorim të apartamentit nr. 1 të ish kopshtit me kontratë huapërdorje për qytetarin z. Viktor Abazaj.
- 13-Projekt-vendim "Për ndryshim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023 " Mbi miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, Njësive Administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024".
- 14-Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4- mujorin e tretë dhe prej fillimit të vitit 2023. Armand Ahmetaj- Kalojmë në votim për rendin e ditës.
- 14 Pro, 2 kundër, abstenim asnjë, miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI
Armand Ahmetaj

Ry
Mjollca Janari
Janari
Kludio Abshonari
Enkelejda Haxhi
Haxhi

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 501 Prot.
10

Patos më 07.03.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 13:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 12.02.2024

Armand Ahmetaj- Nëse ka ndonjë diskutim, pyetje apo sygjerim për korrigjim procesverbali?

Nëse ska pyetje ose sygjerime në bazë të nenit 77 të rregullores e konsiderojmë të miratuar unanimisht me 16 vota pro procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

SEKRETARI

Refaela Xeba

Klaudio Alibonani

Entekjola Hoxhi
Hoxhi

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 501/Prot.
111

Patos më 27 03.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 12.02.2024

Armand Ahmetaj – Të lutem Refaela!

Refaela Xeba, Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 12.02.2024 janë marrë gjithsej 2 vendime vendimi nr. 07 dhe vendimi nr. 08, vendimet janë zbardhur në afat ashtu siç e përcakton ligji dhe rregullorja dhe janë përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Nga këto 2 vendime vendimi 07 ishte me karakter normativ, i cili i është përcjell prefekturës për verifikim dhe na ka ardhur përgjigja se vendimi është në përputhje me ligjin.

Armand Ahmetaj - Po faleminderit! Atëherë vazhdojmë me pikën e radhës.

SEKRETARI

Refaela Xeba

Klaudio Alshonaj

Enkeljda Arzi
Arzi

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4451 Prot.
3

Patos më 07.03.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Janar 2024”.

Armand Ahmetaj – I lutem ekzekutivit, ju informoj se kjo pikë ka kaluar në komisionin e Ekonomisë dhe është votuar unanimisht pro për tu shqyrtuar në këtë mbledhje.

Barie Goxhaj- Për muajin janar 2024 të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor gjithsej 27 familje me një fond prej 80,332 (tetëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë. Lista bashkëngjitur me emrat.

Armand Ahmetaj – Ka ndonjë pyetje? Diskutim?

Armand Ahmetaj -Atëherë kalojmë në votim për miratimin e pikës së katërt të rendit të ditës. Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin janar 2024”.

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARI

Refaela Xeba

Ilirio Ahmetaj

Molla Tase
gjanoff

Enteje do Afzi
Afzi

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 444/Prot.
3

Patos më 07 03.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin janar 2024".

Armand Ahmetaj – Kalojmë për shqyrtimin Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin janar 2024", dua tju theksoj se edhe kjo pikë gjithashtu ka kaluar në komisionin e ekonomise dhe është votuar unanimisht pro për tu shqyrtuar në këtë mbledhje.

Barie Goxhaj- Për muajin janar 2024 nga fondi i kushtëzuar Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Janar 2024 gjithsej 20 familje me një fond prej 89,775 (tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

Armand Ahmetaj – Keni ndonjë diskutim për këtë pikë para se të kalojmë në votim?

Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër për miratimin e pikës së pestë të rendit të ditës, projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin janar 2024".

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 15 vota pro.

SEKRETARI

Refaela Xeba

Vjollca Karaj
Spas

Flaudis Alsinonaj

Enkelejd Agzi
Agzi

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 364/13 Prot.

Patos më 07.03.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis 2024-2029”.

Armand Ahmetaj – Dua t’ju informoj se ky projekt-vendim ka kaluar në komisionin përkatës, ka marrë unanimisht votën për të kaluar në këshill, gjithashtu është bërë dhe dëgjese publike. Ekzekutivi e ka fjalën.

Blerina Laçi - Përshëndetje të gjithëve! Në përmbushje të detyrimeve ligjore të qeverisjes vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të popullatës është hartuar Plani Lokal i Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis. Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Zhurmën është kërkesë e Ligjit nr. 9774, i vitit 2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar me ligjin nr. 50, datë 22.06.2023, sipas shkronjës (a) të nenit 8, ku citohet se bashkia është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve vendor të veprimit për zhurmën.

Ky plan ka qëllim marrjen e masave të domosdoshme për menaxhimin e zhurmës mjedisore, ndaj të cilës ekspozohen njerëzit, në zonat urbane, rurale, në parqet publike, në fusha të qeta në vendet e hapura, afër shkollave, spitaleve dhe objekteve dhe fusha të tjera të ndjeshme ndaj zhurmave. Gjithashtu ky plan veprimi analizon dhe parashikon masa ligjore, administrative dhe organizative të domosdoshme për t’u ndërmarrë në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 50, te vitit 2023 “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”, ligjit nr. 89, te vitit 2022 “Për Policinë Bashkiake” me synimin e administrimit të qëndrueshëm dhe reduktimit të nivelit të zhurmave në mjedis.

Në Plan janë parashikuar një sër masash për të minimizuar ndikimin e masës në mjedis nga subjekte të ndryshme përfshirë ndërmarjet, komunitete dhe individët të tilla si përdorimi i pajisjeve dhe teknologjive më të qeta që mund të ndihmojnë në zvogëlimin e prodhimit të zhurmës përdorimi i barrierave akustike të cilat mund të ndihmojnë në parandalimin e përhapjes së zhurmës në mjedisin përreth. Planifikimi urban dhe ndërtimi i mjedisit me kujdes të cilat gjithashtu mund të ndikojnë minimizimin e zhurmës në komunitet, përdorimi i hapësirave të qeta, largimi i burimit të zhurmës nga zonat rezidenciale dhe planifikimi i rrugëve me kujdes janë disa hapa të tjera të mundshëm.

Burimet kryesore të zhurmave urbane janë :

- Trafiku rrugor
- Industria
- Tregëtia
- Ndërtimi dhe zhurma në godinat e shërbimit.
- Aktivitete të shërbimit social ose argëtuese – Koncertet , Lokale, dite apo nate, ku luhet muzike e lart

Në mbështetje të shkronjës "d" pika 4 të nenit 8 të ligjit nr. 89 datë , datë 22.12.2022 "Për Policinë Bashkiake" pikës 7 të udhëzimit të përbashkët nr. 2 datë 15.11.2023 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme për nivelin kufij të zhurmës për një mjedis të dhënë në fushën e veprimtarive ekonomike shoqërore , zbatimi i këtij plani do të bëhet nga Policia Bashkiake në bashkëpunim me sektorin e pyjeve dhe Mjedisit. Për sa më sipër në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, nenit 8, pikës 6 të nenit 10 të ligjit nr. 50, 2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007, "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", ligjit nr. 89, të vitit 2022 "Për policinë bashkiake", i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

Miratimin e "Planit lokal të menaxhimit të zhurmave në mjedis 2024-2029", sipas shtojcës I bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.

Amand Ahmetaj- Më lini t'ju informoj se është shtuar dhe prezenca e një këshilltari z. Zejni Musaj, prezenca ishte 16 (gjashtëmbëdhjetë) dhe tani është 17 (shtatëmbëdhjetë).

Erald Çepele- Ndërgjegjësimi i qytetarëve është shumë i rëndësishëm në këtë plan.

Eduart Faslliaj- Ju thoni se është planifikuar që të blihet një pajisje. Dmth nuk e kemi?

Blerina Laçi – Është ndryshuar ligji së fundmi i cili detyron Policinë Bashkiake në bashkëpunim me Policinë e shtetit të realizojnë matje sepse tani vetëm instituti i Shëndetit Publik e ka pasur për të matur nivelin e zhurmave, atë pajisje të certifikuar dhe kolauduar sipas ligjit.

Eduart Faslliaj- Si do ti penalizojmë ne këta persona kur ne nuk e kemi ende këtë pajisje.

Blerina Laçi – Në rastin e subjekteve psh si në zonat Industriale subjektet disponojnë një leje mjedisi dhe e kanë detyrim ligjor që atje të kenë dhe kufirin e lejuar të zhurmës dhe domosdoshmërisht një matje ata e realizojnë. Në rastet kur pajisja nuk është blerë ende dhe mund të ndodhi që mund të kemi një ankesë të tillë patjetër që ne do të kërkojmë bashkëpunimin e institucionit përkatës për të kryer matjet e nivelit të zhurmës.

Eduart Faslliaj- Për ndërgjegjësimin e qytetarëve ka ndonjë gjë të parashikuar në plan?

Blerina Laçi – Janë një sër masash të cilat do të ndikojnë në zbutjen e riskut nga zhurmat.

Keni ndonjë diskutim për këtë pikë para se të kalojmë në votim?

Atëherë kalojmë në votim nëse nuk kemi diçka tjetër për miratimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës, Projekt-vendim "Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Zhurmave në Mjedis 2024-2029".

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 17 vota pro.

SEKRETARI

Refaela Xeba



Klaudob Alifinonaj

KRYETARI

Armand Ahmetaj



Mjollca Karesi

Entekedra Azizi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 213 Prot.
13

Patos më 07.03.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë” 2024-2026 në Bashkinë Patos .

Armand Ahmetaj- Të lutem Ekzekutivit të relatoi.

Elda Goxhaj- Përshëndetje të gjithëve! Relacion mbi miratimin e Planit Lokal të Veprimit për rininë 2024 – 2026 në Bashkinë Patos.

Bashkia Patos ka hartuar “Planin Lokal të Veprimit për Rininë 2024-2026”, një dokument që hartohet në zbatim të Ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë” dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, i cili ka si qëllim përcaktimin e veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të rinjve në Republikën e Shqipërisë dhe të rinjve shqiptarë në Diasporë, si dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti.

Gjithashtu Bashkia Patos është bazuar në Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029 si dokument ku bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e rinjve dhe Strategjinë e Bashkimit Europian për Rininë 2019-2027 e cila është korniza për bashkëpunimin e Bashkimit Evropian për politikat rinore.

“Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2024-2026” është hartuar me mbështetjen e Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Europian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD), program i cili bashkëfinancohet 20 % nga Bashkia Patos.

Bashkia Patos në zbatim të këtij programi ka hapur thirrjen për organizatat e shoqërisë civile, duke e vendosur si prioritet hartimin e këtij dokumenti, ku organizata e shoqërisë civile fituese Qendra Rinore “Epoka e Re”, përmes ekspertizës saj vendosi në dispozicion të bashkisë Patos hartimin e këtij dokumenti.

“Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2024-2026” synon të krijoj një udhërrëfyes për nxitjen e një mjedisi ku të rinjtë angazhohen, dëgjohen dhe vlerësohen në mënyrë aktive duke identifikuar fushat kryesore të angazhimit qytetar, punësimit, edukimit, shëndetësisë, sportit, kulturës, sigurisë dhe mbrojtjes.

“Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2024-2026” mbështetet në 6 (gjashtë) objektiva strategjike:

Objektivi 1: Angazhimi qytetar dhe lidershipi.

Objektivi 2: Punësimi dhe sipërmarrja e të rinjve.

Objektivi 3: Edukimi dhe zhvillimi i aftësive.

Objekti 4: Shëndeti dhe mirëqenia.

Objektivi 5: Sport, art dhe kulturë.

Objektivi 6: Siguria dhe mbrojtja.

Ky plan synon të shërbej si një nga dokumentat më të rëndësishëm udhëzues në përmbushjen e detyrimeve dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për të gjithë të rinjtë në të gjithë territorin e bashkisë Patos. Kemi realizuar dhe dëgjuesen publike.

Albiona Lamaj- Duke qënë pjesë e dëgjuesës publike unë përgëzoj bashkinë Patos për nismën megjithatë duhet ta jap dhe si një mesazh këtë gjë sepse atë çfarë pamë në dëgjuesën publike është përfshirja e të rinjëve dhe unë pash që të rinjtë që ishin pjesëmarrës ishin në mënyrë sporadike dhe jo të organizuar nga institucionet përkatës, doja të thoja se kërkesat duhet të vinin zyrtarisht në shkollë, sepse në këtë plan që bëhet jam shumë dakord që duhet marrë edhe mendimi i të rinjëve por ky vendim duhet marrë bashkërisht me stafin pedagojik pasi është shumë i rëndësishëm për më tepër kur bëhet nga një projekt i huaj që ne mund të përfitojmë dhe të rinjtë mund të përfitojnë shume. Sygjerimi im do të ishte se kur bëhen dëgjesa herës tjetër të jetë më e strukturuar kërkesa që do të vij nga të rinjtë.

Elda Goxhaj- Me lejo të them se ne e kemi ezuarur këtë pjesë sepse në momnetin që është ofruar ekspertiza nga qendra Europiane, ai në atë dëgjuesë që ju morët pjesë si këshill ka qënë drafti përfundimtar por gjatë gjithë fazës së hartimit të dokumentit deri sa ne erdhem në draftin përfundimtar, janë realizuar një sër takimesh edhe me institucionet përkatëse ku ZVA përmes shkollave dhe përfaqësim nga senatet e tjerë kanë marrë pjesë. I kemi të dokumentuara të gjitha. Kanë qënë të strukturuar deri në fazën që ne erdhëm në draftin final.

Albiona Lamaj- Po por në draftin final që ne po bëjmë diskutime ata që kanë qënë pjesë në hartimin final duhet të jenë përsëri prezent.

Elda Goxhaj- Kishte të rinj që ishin prezent.

Erald Çepele- Sa është numri i organiztave që janë paraqitur deri më sot nga thirrja që është hapur? A keni përcaktuar një kosto reale çfarë vlere mund të kapi?

Elda Goxhaj- Nuk ka lidhje organizatat që janë paraqitur, ne si bashki gjithë programin ReLOaD2 i cili është program 4-vjeçar ku ne çdo vit hapim thirrje të ndryshme e bashkëfinancojmë në tërësi 20 % të programit dhe për çdo nga thirrjet që bashkia hap është përsëri i njejt prap 20 % të programit që bashkëfinancojmë ne. Kurse për këtë dokument që është hartuar organizata fituese nuk është se fitoj lekët vetëm për të fituar ekspertizën për hartim dokumenti por një nga veprimtaritë e organiztës fituese ishte dhe hartimi i ofrimin të ekspertizës për hartimin e dokumentit. Nuk është se ne kemi financuar vetëm hartimin e këtij dokumenti, jane bërë një sër aktivitete.

Erald Çepele- Sa është numri i organiztave që janë paraqitur projekte nga thirrja?

Elda Goxhaj- Ne nuk e kemi hapur thirrjen për hartim e dokumentit, ka qënë fokus tjetër por është kërkuar te organizata që përmes atij aktivitet të hartohet edhe ky dokument. Sa për propozime ndoshta dhjetë ose pesëmbëdhjetë aplikime mund ta mar si informacion dhe t'jua sjell më vonë.

Armand Ahmetaj – Ka ndonjë pyetje? Diskutim?

Armand Ahmetaj -Atëherë kalojmë në votim për miratimin e pikës së shtatë të rendit të ditës. “Projekt-vendim “Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë” 2024-2026 në Bashkinë Patos .

Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 17 vota pro.

SEKRETARI

Refaela Xeba



Klaudio Abisnonaj

KRYETARI

Armand Ahmetaj



Milica Jareci

Jareci

Entekijola Haxhi
Haxhi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 500 Prot.
15

Patos më 07.03.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave të veta (Bashkia Patos 2025-2027)".

Ekzekutivi Relaton materialin e paraqitur me shkrim.

Armand Ahmetaj -Atëherë kalojmë në votim për miratimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 17 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

Kludio Albinonaj

KRYETARI
Armand Ahmetaj

Molla Xase
Xase

Erkedia Agzi
Agzi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 493 Prot.
13

Patos më 07 .03.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e bonusit të qirasë së qytetarit z. Qerem Zyberi”.

Armand Ahmetaj- I lutem ekzekutivit

Arben Shpërdheja - Në vijimësi të kërkesës të z.Qerem Zyberi për të përfituar bonusin e qirasë si familje në nevojë theksojmë se:

Qerem Zyberi banues në lagjen “Naftëtari” Patos, ka aplikuar si i pastrehë dhe figuron në listën e strehimit me numër rendor 104 (njëqind e katër). Familja e tij përbëhet nga katër persona dhe në përbërjen familjare ka bashkëshorten me aftësi të kufizuar.

Të ardhurat e familjes janë në total 25,446 (njëzet e pesëmijë e katërqind e dyzet e gjashtë) lekë sipas K.M.P.V. Sipas kontratës së qirasë me nr. repertori 3388, nr. koleksioni 1621 datë 04.10.2023 familja e Qerem Zyberi jeton në këtë banesë, me numër pasurie 21/11+3-25, zona kadastrale 2890, volumi 13, faqe 54, me sipërfaqe 48.92 m2 (dyzet e tetë pikë nëntëdhjetë e dy) në lagjen “Naftëtari” Në V.K.B nr. 81, datë 18.12.2023 për miratimin e buxhetit 2024, zëri rimbursimi i familjeve të pastreha për bonus qiraje. Për familjet që si pjesë taksuese sipas normave të strehimit duhet të strehohen në banesën 2+1, vlera në tregun e lirë e tetstuar është 6,000 (gjashtë mijë) lekë dhe rimbursim 50% e vlerës është e barazvlefshme me 3,000 (tre mijë) lekë në muaj. Për periudhën një vjeçare janar-dhjetor 2024 një vlerë totale 36,000 (tridhjetë e gjashtë mijë) lekë. Kjo vlerë tërimbursohet me dy këste, pasi qytetarit mund t'i ndryshoj statusi social.Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1.Miratimin e këtij projektvendimi.

Armand Ahmetaj – Faleminderit! Dua t’ju theksoj se edhe kjo pikë gjithashtu ka kaluar në komisionin e ekonomise dhe është votuar me 4 vota pro për tu shqyrtuar në këtë mbledhje.

Erald Çepele- Atëhere këtu janë dy qytetarë dhe për korrigjim se ky e ka Qerem Zyberaj dhe jo Zyberi se mos na krijon ndonjë konfuzion, mos kemi ndonjë qytetar me të njëjtin emer. Këto janë banesa me qera qe i kanë marrë në të tretë dhe bashkia paguan vetëm bonusin.

Arben Shpërdheja- Bashkia në programe sociale për strehim social jep banesa me qira që i ka të vetat dhe rimbursion 50% të vlerës së qirasë së tregut për familjet në nevojë, që ne nuk kemi mundësi ti strehojmë në banesa sociale.

Armand Ahmetaj – Meqënëse s’kemi pyetje të tjera unë propozojë ta kalojmë në votim.

Atëherë kalojmë në votim.

Kush është dakord për Projekt-vendim “Për miratimin e bonusit të qirasë së qytetarit z. Qerem Zyberi”? Armand Ahmetaj - Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 17 vota pro.

SEKRETARI

Refaela Xeba

Ilirio Alisnonaj

KRYETARI

Armand Ahmetaj

Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos

Molla Kasej
Qasaj

Entekijda Ajazi
Ajazi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4951 / Prot.
3

Patos më 07 .03.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e bonusit të qirasë së qytetarit z. Bardhul Aliaj”.
Armand Ahmetaj- I lutem ekzekutivit

Arben Shpërdheja – E njehta situatë është. Në vijimësi të kërkesës të z. Bardhul Aliaj për të përfutuar bonusin e qirasë si familje në nevojë theksojmë se:

Bardhul Aliaj banues në lagjen “Naftëtari” Patos, ka aplikuar si i pastrehë dhe figuron në listën e strehimit me numër rendor 111 (njëqind e njëmbëdhjetë). Familja e tij përbëhet nga tre persona dhe në përbërjen familjare ka persona me aftësi të kufizuar, e verbër grupi dytë.

Të ardhurat e familjes janë në total 30,584 (tridhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë sipas K.M.P.V. Sipas kontratës së qirasë me nr. repertori 615, nr. koleksioni 201, datë 01.03.2022 familja e z. Bardhul Aliaj jeton në këtë banesë, me numër pasurie 7/81+2-22, zona kadastrale 2890, volumi 8, faqe 120, me sipërfaqe 55 m2 (pesëdhjetë e pesë) kundrejt vlerës 5,000 (pesë mijë) lekë në muaj, me një afat kohor kontrate 5 (pesë) vjeçare.

Në V.K.B nr. 81, datë 18.12.2023 për miratimin e buxhetit 2024, zëri rimbursimi i familjeve të pastreha për bonus qiraje. Për familjet që si pjesë taksuese sipas normave të strehimit duhet të strehohen në banesën 1+1, vlera në tregun e lirë e tetstuar është 5,000 (pesë mijë) lekë dhe rimbursim 50% e vlerës është e barazvlefshëme me 2,500 (dy mijë e pesqind) lekë në muaj. Për periudhën një vjeçare janar-dhjetor 2024 në vlerë totale 30,000 (tridhjetë mijë) lekë. Kjo vlerë të rimbursohet me dy këste, pasi qytetarit mund t'i ndryshoj statusi social.

Armand Ahmetaj – Keni ndonjë pyetje? Meqë s'keni po e kaloj në votim Projekt-vendim “Për miratimin e bonusit të qirasë së qytetarit z. Bardhul Aliaj”. Kush është dakord?

Armand Ahmetaj - Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 17 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

Ilirida Alsinari

KRYETARI
Armand Ahmetaj

Ylli Janaj
Janaj

Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos

Enkeleida Arzi
Arzi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 492 / Prot. 3

Patos më 07.03.2004.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për rikonstrukcion banesash".
Armand Ahmetaj – I lutem ekzekutivit

Arben Shpërdheja Të nderuar Këshilltar !

Tabela e pikëzimit paraqitur sot në K/Bashkiak nga ekipi i menaxhimit është bazuar në pikën 2 dhe 3 të nenit 24, shkronjës "e" të nenit 54 të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 5 i ligjit nr. 9232, dt.13.05.2004, "Për Programet Sociale për Strehim të Banorëve të Zonave Urbane" i ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar si dhe V.K.M. nr. 574, datë 29.08.2012. "Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit", ekipi i menaxhimit në mbledhjen e rradhës pasi shqyrtoi dhe verifikoi në terren kërkesat e paraqitura, problematikën e tyre, si dhe kushtet për këto objekte, vendosi në përfundim të mbledhjes këtë sistem pikëzimi që po ju paraqit. Për bashki të ndryshme specifikat për tu trajtuar me programin e strehimit janë të ndryshme në varësi të rasteve.

Tabela ndahet në katër pika kryesore.

Kushtet e strehimit, kushtet familjare, kushtet sociale, kushtet ekonomike.

Për kushtet e strehimit – është patur parasysh tu jepet përparësi familjeve të cilat posedojnë një banesë për strehim në pronësi dhe përparësi të kenë banesat me moshë të hershme.

Për kushtet familjare – është patur parasysh fakti që familjet një prindërorë dhe ato familje që kanë më shumë se 2 (dy) fëmijë

Për kushtet sociale- ju është dhënë përparësi familjeve me status jetimi persona me aftësi të kufizuar dhe familjeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Për kushtet ekonomike- është marrë parasysh dhe gjendja ekonomike e familjes, ku përparësi ju është dhënë familjeve me të ardhura të pakëta.

Armand Ahmetaj- Kjo pikë është kaluar në të dy komisionet, të Ekonomisë dhe Ligjeve dhe është votuar unanimisht për tu kaluar dhe për tu miratuar në këshill.

Albiona Lamaj- Shikoj që në katër fushat përkatëse ka në disnivel në pikëzim që i jepët më shumë kushteve të strehimit, që do të thotë nëse unë plotësoj kriteret familjarë dhe kriteret sociale i bie që automatikisht që nëse nuk e kam banesën e vjetër nuk futem në këtë pjesën e rikonstruksionit. Te sistemi i pikëzimit shioj një disnivel. Ky është mendimi im gjithmonë.

Arben Shpërdheja- Në cilën pikë?

Albiona Lamaj- Nëse banesa ime do të ishte e ndërtimit para 1950 marrë njëmbëdhjetë pikë por nëse unë jam në kushte familjare jo të mira jam me shtatë por ndërkohë e kam banesën të re por e kam në kushte të amortizuara mar katër. Domethenë njëmbëdhjetë, më kupton çfarë po them?

Armand Ahmetaj – Alba të lutem humbet kuptimi i ndihmës ketu nëse banesa është e re. Komisioni mbështetet në një ligj përpara se të mari një vendim.

Arben Shpërdheja- Më bëj pyetjen të jap përgjigjen.

Albiona Lamaj- Në sistemin e pikëzimit ka një disnivel, nëse maksimumi te kushtet e strehimit është njëmbëdhjetë tek sociali është shtatë. Te sociali është gjashtë dhe te kushtet familjarë është shtatë. Që do të thotë plotësimi i këtyre kriterëve në maksimum dhe me pjesën tjetër përbën disnivel për sistemin e pikëzimit. Që të këtë prioritet të barabartë dhe kushtet sociale me kushtet familjare.

Arben Shpërdheja- Tabela e katër kriterëve është e përcaktuar me vendim qeverie. Nëse ne themi 100 pikë në katër tabelat është e përcaktuar me vendim qeverie. Ndërsa ne kemi detyrimin kur themi kushtet e strehimit ky tridhjetë pikësh është për kushtet e strehimit, nuk mund të kaloj 40 pikë kushtet e strehimit Nëse do themi kushtet familjare 20 pikë e ka përcaktuar ligji.

Erald Çepele – Nëse i plotëson të gjitha kushtet e tjera dhe vetëm te kushti i strehimit ai mund ta ketë banesën, dikush e ka banesën para viteve 50 dhe e ka shumë herë në gjendje më të mirë se ai që e ka të vitit 70.

Arben Shpërdheja- Në këtë pikë ka një komision që e vlerëson.

Armand Ahmetaj – Prandaj bëhet sistemi i pikëzimit për të diferencuar kush do të ndihmohet.

Arben Shpërdheja- Të kemi parasysh nëse themi banesë pas viteve 90 nuk besoj se ka nevojë për rikonstruksion.

Erald Çepele – Marim një familje që ka më shumë se dy fëmijë, një familje që ka invalid në shtëpi, ka jetim atëherë i mer të gjitha pikët e kolonës dhe penalizohet vetëm tek kushtet e strehimit se mund ta ketë banesën të viteve nëntëdhjetë mer vetëm një pikë.

Arben Shpërdheja- Tek të tjera këto kolonat, nëse është një grua kryefamiljare do të mari shtatë pikë psh do të mari dhe katër pikë sepse ka dhe dy fëmijë, brenda kuadratit do të mari maksimalin e pikëve për atë çfarë vlerësohet.

Armand Ahmetaj - Kush është dakord për Projekt-vendim “Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për rikonstruksion banesash”?

Armand Ahmetaj - Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 17 vota pro.


SEKRETARI
Refaela Xeba



Jakub Alisnonoj



KRYETARI
Armand Ahmetaj



Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos

Entelejda Arzi
Arzi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 499 / Prot.
3

Patos më 07 .03.2004.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dymbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e dhënies në përdorim të apartamentit nr. 1 të ish kopshtit me kontratë huapërdorje për qytetarin z. Viktor Abazaj.

Shenim (Suela Hoxhaj largohet nga mbledhja).

Armand Ahmetaj – Ju njoftoj se si çdo pikë tjetër edhe kjo ka kaluar për shqyrtim në komision dhe është votuar unanimisht dhe është vendosur ti propozohet këshillit miratimi i kësaj pike. I kalojmë fjalën ekzekutivit:

Arben Shpërdheja- Bazuar në vendimin nr. 88 datë 25.11.2022 me nr. 2890/3 prot., datë 30.11.2022 të Këshillit të Bashkisë Patos "Për miratimin e masës së qirasë për banesat sociale për ish kopështin në lagjen Mustafa Matohiti" është vendosur që masa e qirasë për apartamentin 1 me sip. 73.2 m² në katin përdhe të godinës të ketë një vlerë vjetore qiraje 30,705 (tridhjetë mijë e shtatëqind e pesë) lekë, e plotëpjestuar me / 12 e barabartë me 2,558 (dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë në muaj. Bashkia Patos duke marr parasysh kërkesën për strehim të z. Viktor Abazaj si dhe kushtet sociale ekonomike ka vendosur që ky qytetar të strehohet në apartamentin nr. 1 të ish kopështit. Nisur dhe nga Raporti mbi vlerësimin e gjëndjes social ekonomike për familjen e z. Viktor Abazaj lëshuar nga sektori i shërbimit social ju bëjmë me dije se:

Familja e z. Viktor Abazaj është familje që përbëhet prej 4 anëtarësh, 2 bashkëshortët si dhe 2 fëmijët (djalë dhe vajzë). Që të dy fëmijët e familjes Abazaj vuajnë prej vitesh nga problemet e shëndetit mendor, sëmundje ndaj të cilës kanë përfutuar kempin dhe masa e përfitimit për të dy fëmijët është 20,610 (njëzet mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë. Gjithashtu familja Abazaj trajtohet me ndihmë ekonomike në një vlerë prej 4,991 (katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një) lekë në muaj. Në total familja Abazaj merr një vlerë mujore 25,601 (njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e një) lekë dhe klasifikohet në familje me të ardhura të ulta. Në këto kushtet që ndodhet kjo familje kërkojmë nga këshilli bashkiak miratimin e dhënies në përdorim të apartamentit nr. 1 të ish kopshtit me kontratë huapërdorje për qytetarin z. Viktor Abazaj.

Armand Ahmetaj - Kush e do fjalën?

Eduart Faslliaj- Kisha dy pyetje më shumë si sqarim? Kemi rast tjetër kur kemi dhënë banesa në përdorim të kësaj kategorie ose më në nevojë se kaq? Apo ky është rast i vetëm?

Arben Shpërdheja- Është rast i vetëm.

Eduart Faslliaj- Atij i është dhënë komplet banesa, apo janë dy apartamente?

Arben Shpërdheja- Janë dy apartamente.

Eduart Faslliaj- Ne miratojmë dhënie në përdorim por nuk kishte një afat kohor është e pacaktuar apo është për gjithë kohën këtu?

Arben Shpërdheja- Kontratat janë 1-vjeçare.

Armand Ahmetaj - Kemi pyetje tjetër ? Kush është dakord për “Për miratimin e dhënies në përdorim të apartamentit nr. 1 të ish kopshtit me kontratë huapërdorje për qytetarin z. Viktor Abazaj”?

Armand Ahmetaj - Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARI

Refaela Xeba



Jelaudis Alislonaj

KRYETARI

Armand Ahmetaj



Alpolcar Jaso
Alpolcar



Enkelijs, Ajzi
Ajzi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 498/Prot.
/3

Patos më 07.03.2004.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së trembëdhjetë të rendit të ditës.

Projektvendim “Për ndryshim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023 “ Mbi miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, Njësive Administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024”.

Armand Ahmetaj – I lutem ekzekutivit.

Juela Shpata- Faleminderit Kryetar! Përhëndetje të gjithëve. Sot paraqesim pranë jush projekt-vendimin nr. 16 datë 19.02.2024 për ndryshim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023 “ Mbi miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, Njësive Administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024”.

Referuar daljeve në pension dhe largimeve nga puna gjatë muajit janar, shkurt si dhe shpalljes vakante të këtyre pozicioneve kërkojmë ndryshimin e disa kategorive në disa pozicione të strukturës.

Konkretisht pika 5, shkronja “ç” dhe pika 7, në nivelin e pagës së Administratës së Bashkisë, Arsim Kulturës, Klubit Shumësportësh “Albpetrol”, Njësiti Administrative Ruzhdie dhe Zharrëz, punonjësit e Ujitjes dhe Kullimit, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

Pika 5 konstiton në rritjen e pagës së pozicionit të përgjegjës të sektorit të emergjancave civile, kjo pasi këtij pozicioni i është bashkëlidhur edhe funksioni i strehimit social.

Në pikën 7, është shtuar një pozicion i ri, pozicioni i Specialistit të Burimeve Njerëzore, ky pozicion nuk është parashikuar në VKB nr. 74, por theksoj që do të suprimohet një vend tjetër që është i inxhinierave dhe nuk do të cënohet asnjë vend tjetër në strukturë. Pra nuk kemi ndryshim të numrit të përgjithshëm të miratuar me vendim nr. 74.

Gjithashtu një ndryshim tjetër është edhe Pika 4, në nivelin e pagave në Agjencinë e Shërbimeve Publike, ky ndryshim vjen si pasojë e daljes në pension të Përgjegjës të Sektorit të Pastrim - Gjelbërimit të Agjencisë së Shërbimeve Publike.

Eduart Faslliaj- Unë nuk isha dakord që ky projekt-vendim të hynte në rendin e ditës pasi nuk mendoj se mund ta sqaroni brenda këtij afati kohor. Gjithësesi përfitoj nga rasti dhe dua të bëj dy pyetje. Me çfarë kuptova nga referenca juaj ajo përqindje që rritet, ne e kemi miratuar paktën fiskale dhe nivelin e pagave dhe kemi parashikuar në buxhet kjo nuk është e parashikuar. Me sa kuptova suprimohet nga pjesa e vendeve që janë të paplotësuara.

Juela Shpata- Këto lëvizje do të mbulohen nga fondi i pagave nga pozicionet që janë vakante në administratë.

Eduart Faslliaj- Në rast se do të ndodh që do paraqiten?

Juela Shpata- Nuk kanë efekt financiar këto. Është rritje pagash që do të mbulohen brenda pozicioneve vakante.

Eduart Faslliaj- Dhe një pyetje tjetër se pash një diferencizëm dikush me 1% dhe dikush me 2%?

Juela Shpata- Në bazë të vjetërsisë punonjësit që janë me arsim të lartë e kanë 2% vjetërsinë ndërsa punonjësit që janë me arsim të mesëm dhe me pagë minimale e kanë 1%. Kështu është në VKM.

Armand Ahmetaj - Kemi pyetje tjetër ? Kush është dakord për projekt-vendimin "Për ndryshim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 30.11.2023 " Mbi miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, Njësive Administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024".

Armand Ahmetaj – Asnje kundër, 2 abstenim , miratohet me 14 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba

Jkando Alsinari

KRYETARI
Armand Ahmetaj



Molla Xeba
Zate

Enkejda Arzi
Arzi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 618 / Prot.

Patos më 07 .03.2004.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 29.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërbëdhjetë të rendit të ditës.

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4- mujin e tretë dhe prej fillimit të vitit 2023.

Armand Ahmetaj- I lutem ekzekutivit.

Mimoza Shtëmbari – Relaton materialin e paraqitur me shkrim.

Klaudio Alisinanaj- Dëgjova që është realizuar 84% e buxhetit. Ok është me rritje, përgëzime ekzekutivit. Është bërë ndonjë analizë pse nuk është realizuar më shumë se 84%?

Mimoza Shtëmbari- Ky raport është i publikuar me shumë transparencë tek faqja e Bashkisë. Mos realizimet dhe realizimet.

Armand Ahmetaj- Faleminderit! Kjo pikë nuk kalon në votim.

SEKRETARI
Refaela Xeba

Klaudio Alisinanaj

Molla Karol
Lasejfo

Entekajola Haxhi

KRYETARI
Armand Ahmetaj